



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 13.2.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 9948, DATË 7.7.2008 “PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”, në mbledhjet e tij të datës 24 tetor 2018 dhe 13 shkurt 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Besnik Baraj.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit, përveç propozuesit të projektligjit Z. Erion Braçe, ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar” është nismë e deputetit Erion Braçe dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Bashkë me këtë projektligj duke qenë se zbatimi i tyre lidhet me të njëjtën problematikë dhe subjekte, propozuesi ka paraqitur edhe një nismë “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar”.

Pas nisjes së shqyrtimit të këtyre nismave, me dt. 24 tetor 2018, Komisioni u njoh me faktin që qeveria po përgatiste dy projektligje të reja, konkretisht projektligji “Për Kadastrën” dhe projektligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë. Projektligji i parë është kthyer në ligj, por duke qenë se projektligji i dytë nuk është votuar akoma dhe këto ligje komplementojnë njëri tjetrin, atëherë u vendos që të rimereshin në shqyrtim nismat e deputetit Braçe për ndryshime në legjislacionin ekzistues të fushës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Qëllimi i këtij projektligji është rishikimi i disa dispozitave të ligjit aktual të cilat kanë krijuar problematika në zbatimin e tij.

Konkretisht, projektligji synon të bëjë disa ndryshime që lidhen me:

- Saktësimin e përkufizimit të përdoruesit faktik të tokës bujqësore, duke përfshirë në këtë kategori të gjithë individët ose familjet bujqësore që kanë qenë banorë të njësisë vendore në datën 1.8.1991, por që për arsye të ndryshme nuk janë pajisur me aktin e marrjes në përdorim ose në pronësi të tokës;
- Parashikimin e një dispozite për zgjidhjen e problematikës dhe pajisjen me Aktin e Marrjes në Pronësi të Tokës, për të gjithë përdoruesit e tokës bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore, të cilët disponojnë tokë bujqësore në përdorim në zbatim të vendimit nr. 255, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe që u është ndarë tokë në përdorim nga 1000 m² deri 4000 m².
- Shtyrjen me 6 muaj të përfundimit të afatit të aplikimit për kalimin në pronësi të tokës bujqësore.

Me anë të këtij projektligji do të bëhet e mundur zgjidhja e problemeve të mbartura në vite, në lidhje me plotësimin e dokumentacionit ligjor në territoret e ish-ndërmarrjeve bujqësore.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Projektligji nuk përafron e nuk lidhet me asnjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Ky projektligj nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që problematikat me pronësinë e tokës që ndeshen shpesh në vend, janë bërë pengesë për zhvillimin ekonomik të vendit dhe shprehu bindjen që këto nisma ligjore do të ofrojnë zgjidhje të problematikave të konstatuara nga propozuesi i tyre.

Propozuesi i projektligjit, Z. Braçe, shpjegoi që me këto projektligje synon një zgjidhje përfundimtare problematikës që haset sot në territore rurale dhe, mbi të gjitha, në territoret bujqësore. Konkretisht, kërkon të zgjidhë problematikën e atyre individëve apo familjeve bujqësore që tashmë posedojnë një akt të marrjes në përdorim të tokës bujqësore e cila ka qenë në administrim të ndërmarrjeve bujqësore.

Projektligji propozon shtyrjen e datës 1 gusht 1991 pasi kjo datë është penalizuese për shumë individë, dhe synon të zgjidhë problematikën e këyre individëve të cilët kanë marrë tokë në përdorim sipas normës për frymë por toka e tyre ka mbetur në përdorim, sepse ligji ndalon apo kufizon marrjen e tokës në pronësi për këto familje, të cilat kanë provuar që pasaportizimi i tyre ka ndodhur pas datës 1 gusht të vitit 1991.

Projektligji synon edhe zgjidhjen e problemit të familjeve bujqësore apo edhe individëve, të cilët në periudhën apo në momentin kur ka ndodhur procesi i regjistrimit të tokës pas ndarjes për efekt të certifikimit të saj me certifikatë pronësie nuk kanë qenë në këtë territor dhe nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi, por vendbanimin e përhershëm e ka pasur në këto territore.

Gjithashtu, projektligji synon shtyrjen e afatit të aplikimit për kalimin në pronësi me 6 muaj, me qëllim që të zgjidhë problematikën e atyre familjeve, të cilat janë zhvendosur me vendime të Këshillit të Ministrave nga pjesë të ndryshme të territorit të vendit në brendësi të territorit vendosur në këto zona, pra në tokat që janë administruar nga ndërmarrjet bujqësore. Afati i caktuar për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi dt. 31.12.2018 i penalizon këto familje për të kryer këtë proces.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u shprehën dakord me projektligjin në mënyrë që edhe kjo kategori të përfitojë aktin e marrjes së tokës në pronësi.

Gjatë diskutimeve në Komision, deputetët shprehën shqetësime në lidhje me: ecurinë e deritanishme të procesit të pajisjes me Akte të Marrjes së Tokës në Pronësi; problematika të tjera të hasura gjatë këtij procesi; impaktin social ekonomik që do të ketë zbatimi i këtij projektligji; kohën

e nevojshme që i duhet kësaj kategorie për t'u pajisur me këtë akt; mjaftueshmërinë apo jo të afatit të propozuar nga propozuesi dhe Komisioni për Çështjet Ligjore për vazhdimin e këtij procesi; etj.

- ***Ndryshime të projektligjit***

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni u njoh me ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe u shpreh dakord me to. Duke qenë se në tekstin e projektligjit nga Komisioni për Çështjet Ligjore janë paraqitur shumë ndryshime dhe shtesa, Komisioni vendosi t'i propozojë seancës plenare një draft të integruar të projektligjit me këto vërejtje:

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi nevojën e këtij projektligji me qëllim përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore, duke qenë se akoma nuk është miratuar projektligji i ri “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Besnik BARAJ

Niko PELESHI

Relator

Kryetar